



KONTROLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 732/8 Prot.

Tiranë, më 19/12/2016

V E N D I M

Nr. 148, Datë 19/12/2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË DEVOLL “MBI VLERSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare”, të ushtruar në Bashkinë Devoll dhe ish Komunitat Qendër Bilisht, Miras, Progër dhe Hoçisht, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë

27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse (vendimet ekzekutive). **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim sistemimin, likuidimin e vlerave në shumën **61,215,071 lekë** dhe veçanërisht arkëtimin e të ardhurave të munguara nga taksat vendore në vlerën 14,496,979 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi. Në auditimin e kryer për administrimin e aseteve në Bashkinë Devoll dhe ish komunat Miras, Qendër Bilisht, Progër dhe Hoçisht, u konstatua se ky aktivitet nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e nenit 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, neni 6, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimi nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”, kjo për shkak të funksionalitetit të munguar të zyrës së menaxhimit të aseteve (për prona publike, objekte, toka, troje, rrugë, pyje, kullota, etj.), strukturë e cila duhet të realizonte administrimin dhe menaxhimin e aseteve për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV^{ve}.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masa për krijimin e një njësie funksionale të menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në Rregulloren e Brendshme detyrat konkrete për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP Devoll, si dhe krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Devoll.

Brenda muajit Shkurt 2017

2. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Progër ushtrojnë aktivitet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore 3 subjekte, ku për 2 subjekte janë lidhur kontrata qiraje, si: subjekti ■■■ për sipërfaqen pyjore 300 m² dhe subjekti ■■■ për sipërfaqen 300 m², ndërsa për subjektin ■■■ me sipërfaqe 6.4 ha nuk është lidhur kontratë qiraje. Për këto sipërfaqe nga ish Komuna Progër nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3,7,9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”.

2.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashkinë Devoll, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private ■■■, ■■■ dhe ■■■, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Brenda muajit Shkurt 2017

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Devoll, u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planet e Detajuara Vendore. Gjithashtu nuk është ngritur dhe miratuar struktura e

Këshillit Teknik me specialitë të fushës për marrjen në shqyrtim të lejeve zhvillimore, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 10, të ligjit nr. 110/2013, datë 01.04.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim, Zhvillim Territorit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak dhe më pas në KKT, Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planet e Detajuara Vendore, më pas të vijnë procedurat për dhënien e lejeve të shfrytëzimit dhe përdorimit për objektet private ose publike

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa për ngritjen e Këshillit Teknik me specialist të fushës dhe në asnjë rast lejet e zhvillimit të mos lëshohen pa u miratuar në Këshillin Teknik.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 3 praktikave për leje zhvillimi, 39 praktikave për leje përdorimi në Bashkinë Devoll dhe 1 praktikë leje zhvillimi në ish Komunën Progër, të cilat u audituan të plota, u konstatua se dosjet nuk janë të inventarizuara për çdo fletë dhe nuk është hartuar fleta e inventarit për dokumentacionin në dosje, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim, Zhvillim Territorit, të marrë masa që të gjitha dosjet e pajisura me leje zhvillimi dhe përdorimi dhe që janë mbyllur procedurat, të bëhet inventarizimi dhe dorëzimi në arkivin e Bashkisë Devoll.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me administrimin e të ardhurave vendore në Bashkinë Devoll dhe ish komunat Miras, Qendër Bilisht, Progër dhe Hoçisht, u konstatua se veprimet nuk janë në përputhje me pikën 7 të nenit 3, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi:

Mungojnë regjistrat e subjekteve fizik, juridik, shtetërorë dhe abonentëve familjarë, për evidentimin e vlerës së detyrimit që ato kanë dhe vlerën e detyrimit të mbetur.

Mungojnë kontrollet mbi mbajtjen e dokumentacionit ligjor, pagesave të kryera, përdorimin e kasës fiskale, etj.

Nuk plotësohej dhe dërgohej tek abonentët familjarë njoftim detyrimi për taksat e tarifave vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, vlerën e paguar dhe vlerën e mbetur.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Devoll, të marrë masa për krijimin e regjistrat elektronik me të dhëna, për:

-Hapjen e kartelave individuale të subjekteve fizikë, juridikë dhe abonentëve familjarë.

-Hartimin e planit vjetor të kontrollit sipas drejtimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore.

-Hartimin e regjistrat themelorë të subjekteve fizike, juridike dhe abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë dhe tarifë vendore.

-Njoftimin e abonentëve familjarë për detyrimet që ato kanë për taksat e tarifave vendore, duke shfrytëzuar si agjent tatimor Ujësjellës Kanalizime.

Brenda muajit Shkurt 2017

6. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Devoll, u konstatua se nuk janë ndarë detyrat për secilin inspektor, si dhe nuk është bërë inventar fizik i dosjeve të Bashkisë Devoll dhe të ish komunave, me qëllim evidentimin e dokumentacionit që mungon, si: njoftim-vlerësim detyrimi, kopje e dokumentit të pagesës së detyrimeve, gen-plani i objektit, etj, veprim në kundërshtim me nenin 29, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Devoll, të marrë masa për ndarjen e detyrave për secilin punonjës, si dhe plotësimin me dokumentacionin e

nevojshëm ligjor të dosjeve të tatimpaguese me: njoftim vlerësimi tatimor, njoftim detyrimi, dokumenti i pagesës së detyrimit (mandat arkëtimi), gen-planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, akt-konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, kjo e fundit konfirmuar nga Policia Bashkiake.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Progër numri i familjeve që paguajnë tarifë pastrimi dhe ndriçimi nuk është i njëjtë me numrin e familjeve që paguajnë taksë toke (ndryshimi me 394 familje). Gjithashtu dhe për taksën e ndërtesës (ndryshimi me 396 familje), evidentohet mos planifikim dhe arkëtimin për vlerën **498,960 lekë, e ardhur e munguar në buxhet**, veprime në kundërshtim me nenet 4, 26 dhe 32, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Devoll, në bashkëpunim me Njësinë Administrative Progër, të evidentojë abonentët familjarë të cilët nuk kanë bërë të mundur likuidimin e detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tokës bujqësore për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën prej **498,960 lekë**.

Brenda muajit Shkurt 2017

8. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pamjaftueshme e punonjësve të cilat janë ngarkuar me administrimin e taksave dhe tarifave vendore deri me 31.12.2015, nuk janë paguar taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **12,369,576 lekë**, nga e cila Bashkia Devoll (ish Bashkia Bilisht) në vlerën 5,977,826 lekë, ish Komuna Miras në vlerën 1,542,000 lekë, ish Komuna Qendër Bilisht në vlerën 2,362,548 lekë dhe ish Komuna Progër në vlerën 2,487,576 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, pikat 88, 89, 32, 89.3 dhe 96, pasi nuk janë ndjekur plotësisht procedurat ligjore në arkëtimin e debitorëve.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Devoll, të marrë masa për **nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore**, bazuar në pikën 3 të nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar për arkëtimin e vlerës **12,369,576 lekë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhërat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b. T’i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit, vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

Brenda muajit Shkurt 2017

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), u konstatua se për subjektet të cilët kanë ndërtuar pa leje janë mbajtur **24 vendime administrative** (me gjobë) në vlerën **3,600,000 lekë** (sipas pasqyrës Aneks 25, bashkëlidhur Raport Auditimit), vlerë kjo e pa kontabilizuar në librat e llogarive të ish Bashkisë Bilisht (sot Bashkia Devoll) dhe pa ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e gjobave, veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, nenet 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, VKM nr. 862, datë 05.12.2007

“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”, ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Po kështu Bashkia Devoll nuk ka ndjekur procedurat dhe kërkuar në Gjykatë për rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 24, 30 dhe 43, ku edhe pse sipas këtij të fundit për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative organet e administratës përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e tarifave gjyqësore, pasi këto përballohen nga kundërvajtësi.

9.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor (IMTV), në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Devoll, të marrë masa për kontabilizim e gjobave dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës **3,600,000 lekë**, sipas pasqyrës Aneks 25, bashkëlidhur Raport Auditimit, si dhe të kërkojë në gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve.

Brenda muajit Shkurt 2017

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer për zbatimin e punimeve në objektin “Rehabilitim asfaltim rruga Vishocicë-Trestenik” (ish Komuna Qendër Bilisht) dhe objektin “Rehabilitim i rrugës së fshatit Cangonj” (ish Komuna Progër), u konstatua se punimet nuk kanë përfunduar në afat dhe se në dosjen teknike nuk ka asnjë dokument të dorëzuar pranë ish Autoritetit Kontraktor (Komuna Qendër Bilisht, Progër), Bashkia Devoll dhe Arkivës Shtetërore Vendore Korçë, mbi mos përfundimin punimeve sipas kontratës, edhe pse nga afati fillestar i caktuar për përfundimin e punimeve kanë kaluar 3 vjet.

Për vonesën në afat të punimeve dhe pezullimin e tyre, nuk rezulton të ketë dokumente justifikuese, sipas nenit 6 “Komunikimi” dhe nenit 17, pika 18.2 “Negociatat dhe amendamentet”, pasi në korrespondencat e mbajtura nga Autoriteti Kontraktor (Ish Komuna Progër dhe Qendër Bilisht) – Firmë sipërmarrëse – Mbikëqyrës, nuk rezulton asnjë amendament kontrate dhe gjurmë auditimi justifikuese për sa i përket pezullimit të punimeve. Nga ish titullarët e Komunës Progër dhe Qendër Bilisht, nuk janë marrë masa për zbatimin e kontratave lidhur me investimin, për të argumentuar mos vijimin e punimeve në objekt, si dhe masa për aplikimin e dëmshpërblimeve mbi vonesën në kryerjen e punimeve, siç parashikohet në nenin 26 “Dëmshpërblimi për Vonesat”, vonesa të cilat sipas kontratave respektive nr. 2, datë 18.6.2013 dhe nr. 248, dt. 17.9.2013, përlllogariten në vlerën totale prej **23,766,561 lekë**, nga e cila për objektin “Rehabilitim asfaltim rruga Vishocicë - Trestenik”, në vlerën 11,954,313 lekë dhe objektin “Rehabilitim i rrugës së fshatit Cangonj”, për vlerën 11,812,248 lekë.

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, të analizojë kushtet dhe arsyet e mos përfundimit në afat të punimeve për objektin “Rehabilitim asfaltim rruga Vishocicë - Trestenik” (ish Komuna Qendër Bilisht) dhe objektin “Rehabilitim i rrugës së fshatit Cangonj” (ish Komuna Progër), duke nxjerrë përgjegjësitë individuale ligjore për personat dhe subjektet përgjegjëse, si dhe në rast të mos dokumentimit ligjor të arsyeve dhe shkaqeve të mos përfundimit në afat të punimeve, të aplikohet penalitetet për vonesa në vlerën prej **23,766,561 lekë**.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në dokumentacionin e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), konstatohet se në **4 raste** nuk janë aplikuar masat administrative me gjobë ndaj subjekteve të cilët kanë ndërtuar pa leje në vlerën **2,000,000 lekë**, e ardhur e munguar në buxhet, veprim në kundërshtim me pikën 8/a e nenit 82, të

ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, ndryshuar me ligjin nr. 110/2013, dhe e ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban”, neni 52, pika 1, germa (e).

11.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Devoll, të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në kallëzim penal për personat të cilët kanë kryer ndërtime pa dokumentacion tekniko ligjor, duke aplikuar penalitet me gjobë në masën 500,000 lekë secili, *respektivisht ndaj subjekteve:* ■■■ për vendosje table, ■■■ për rrethim shkalle hedhje betoni dhe solete, ■■■ për prishje trotuari dhe hapje themelesh si dhe subjektin ■■■ për hedhje betoni kati i III dhe zgjerim sipërfaqe rrethim mur tulle.

Brenda muajit Shkurt 2017

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i KLSH por dhe nga vet Bashkia Devoll, mbi zbatimin e kontratës datë 15.06.2015, lidhur mes ish Bashkisë Bilisht dhe subjektit ■■■ është konstatuar se nënshkrimi i saj ka sjellë pasoja negative në financat e Bashkisë Devoll, veprim në kundërshtim me Kodin Civil, neni 32, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin”, dhe VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”.

Me konstatimin e paligjshmërisë të kontratës Bashkia Devoll, ka kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë “*Pavlefshmërinë absolute të kontratës të datës 15.06.2015*”, kërkesë kjo e rrëzuar nga Gjykata me vendimin nr. 424 datë 01.03.2016.

Me kërkesën ankimore nr. 481, datë 15.03.2016, Bashkia Devoll ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor, ankesë për të cilën Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 249, datë 28.06.2016 është shprehur duke lënë në fuqi vendimin nr. 424, datë 01.03.2016 të Gjykatës së Shkallës Parë Korçë.

Me shkresën nr. 1441, datë 27.07.2016, Bashkia Devoll ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë me objekt: “*Prishjen e vendimit nr. 249, datë 28.06.2016 të Gjykatës së Apelit Korçë, vendimit nr. 424, datë 01.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për konstatim pavlefshmërisë absolute të kontratës së datës 15.06.2015, si dhe dëm në vlerën 160,200 lekë*”, çështje e cila ende nuk rezulton të jetë marrë në shqyrtim.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll nëpërmjet Sektorit Juridik, të ndjekë në Gjykatën e Lartë, ankimin ndaj vendimit nr. 249, datë 28.06.2016 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimit nr. 424, datë 01.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke shtuar në ankimin nr. 1441, datë 27.07.2016 dhe duke i parashtruar gjykatës të gjitha shkeljet ligjore dhe procedurale të bëra prezent nga auditimi i kryer.

Në përfundim të procesit vendimmarrës, nëse Gjykata e Lartë nuk do të shprehet për pavlefshmërinë absolute të kontratës datë 15.06.2015, duke nënkuptuar lënien në fuqi të vendimeve të ankimuara, Bashkisë Devoll i lind e drejta dhe detyrimi i rregullimit të objektit të padisë, duke kërkuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë “*Pavlefshmërinë Relative të kontratës të datës 15.06.2015*”. Kërkimi i pavlefshmërisë relative të kontratës datë 15.06.2015 në kuptim të ligjit nuk përbën *Res Iudicata*, (gjë të gjykuar) duke nënkuptuar të drejtën e bashkisë të kërkoj nga gjykata të shprehet me vendim mbi pavlefshmërinë relative të kontratës.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pagesave të kryera për organizim dhe realizimin e aktiviteteve social-kulturore, u konstatua se në 6 raste janë kryer pagesa për festën e Romëve dhe të 8 Marsit, duke shtruar dreka dhe kokteje me vlerë 314,000 lekë, por dokumentacioni ligjor që shoqëron këto pagesa nuk është i rregullt, pasi mungon programi kulturor i hartuar nga Sektori i Kulturës dhe miratuar nga Titullari, veprime në kundërshtim me pikën 26 të

nenit 4, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pikat 35 e 36, si dhe VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999.

13.1. Rekomandimi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Devoll në bashkëpunim me Sektorin e Kulturës dhe Sporteve, të marrë masa që organizimi i aktiviteteve social kulturore të bëhen në bazë projektesh, preventivash dhe kontratash.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer mbi pagesat për shpenzime me furnizim me energji elektrike sipas faturave tatimore të lëshuara nga ■■■, u konstatua se në faturimet për harxhimin e energjisë ka shtuar si zë shpenzimi taksën e televizorit për linjat e ndriçimit rrugor dhe stacioneve të ujit të pijshëm të administruara nga Bashkia Devoll, veprime në kundërshtim me nenin 9, pika 4, neni 12, pika 3, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, duke rritur shpenzimet me një efekt financiar negativ në vlerën **103,500 lekë**.

14.1. Rekomandimi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik në Bashkinë Devoll, të marrë masa duke ndjekur rrugët administrative dhe gjyqësore mbi faturimet e taksës së televizorit në linjat e ndriçimit rrugorë dhe stacionet e ujit të pijshëm nga objekti ■■■.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të paraqitur nga Drejtorja e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Devoll dhe ish Komunën Hoçisht (akt-konstatime dhe procesverbale), u konstatua se:

a- 13 subjekte në Bashkinë Devoll, ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKR, DRT Korçë dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhet për vlerën **1,147,143 lekë**;

b- 13 subjekte në ish Komunën Hoçisht, nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore në vitet 2014 – 2015, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhet për vlerën **481,300 lekë**, veprim në kundërshtim me nenet 4 dhe 5, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, ndryshuar dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

15.1. Rekomandimi: Drejtorja e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të evidentojë, saktësojë, llogarisë dhe arkëtojë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,628,443 lekë nga 26 subjekte të Bashkisë Devoll dhe ish Komunës Hoçisht**, bazuar në nenin 70, të ligjit nr. nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Brenda muajit Shkurt 2017

16. Gjetje nga auditimi: Në auditimin mbi administrimin e aseteve në Bashkinë Devoll, u konstatua se për 4 (katër) familje janë lidhur kontrata me personat e pastrehë në ambientet e vëna në dispozicion (banesa sociale), me tarifë mujore prej 3,300 lekë/muaj, ku për periudhën 01.01.2013-30.06.2016 nuk është likuiduar vlera prej **554,400 lekë**, si një e ardhur e munguar në buxhet.

16.1. Rekomandimi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Sektorin Juridik, të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve për qiranë e banesave në vlerën 554,400 lekë, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim arkëtimin e vlerës **554,400 lekë**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shkurt 2017

17. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer për zbatimin e detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme në ish Bashkinë Bilisht dhe ish Komunat Miras e Qendër Bilisht, u konstatua se veprimet e kryera nuk janë në përputhje me detyrat e lëna për zbatimin e rekomandimeve, *respektivisht:*

Në ish Bashkinë Bilisht, nga 9 masa organizative me vlerë 14,575,000 lekë nuk janë zbatuar 5 masa me vlerë **13,457,000 lekë** dhe nga 4 masa shpërblim dëmi me vlerë 280,500 lekë janë në proces zbatimi 4 masa në vlerën **273,500 lekë**.

Në ish Komunën Miras, nga 3 masa organizative nuk është zbatuar një masë, ndërsa 1 (një) masë shpërblim dëmi me vlerë **2,350,466 lekë**, rezulton e pazbatuar.

Në ish Komunën Qendër Bilisht, nga 2 masa shpërblim dëmi në vlerën 1,994,812 lekë është në proces zbatimi një masë për vlerën e mbetur prej **989,665 lekë**.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara plotësisht ose pjesërisht, për 6 masa organizative me vlerë **13,457,000 lekë** dhe 7 masa shpërblim dëmi me vlerë **3,613,631 lekë**, *respektivisht:*

a-Në ish Bashkinë Bilisht, për 5 masa organizative me vlerë **13,457,000 lekë** dhe 4 masa shpërblim dëmi me vlerë.

b-Në ish Komunën Miras, për një masë organizative dhe një masë shpërblim dëmi me vlerë **2,350,466 lekë**.

c- Në ish Komunën Qendër Bilisht, për 2 masa shpërblim dëmi në vlerën **989,665 lekë**

Brenda muajit Shkurt 2017

18. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Devoll është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por nuk ka funksionuar. Nuk është hartuar plani strategjik i menaxhimit financiar, ku të përfshihej misioni, vizioni, objektivat, plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e MFK. Nga menaxheri i njësisë vendore nuk ishin marrë masa trajnuese për njohjen e këtij ligji dhe vënien në zbatim të tij, me qëllim zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë për menaxhimin e riskut për realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ai drejton.

Hartimi i deklaratës së cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportit vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë me vërtetësi dhe sinqeritet realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për ngritjen e një sistemi të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në fund të periudhës ushtrimore të bëhet vetëvlerësimi dhe të raportohet për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i njësisë**

publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 58,896,283 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, u konstatua se për **12 subjekte** detyrimet për taksat e tarifave vendore janë në kundërshtim me VKB dhe nenin 12, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe nenit 112, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke evidentuar mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Devoll për **vlerën 1,502,350 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të evidentojë, saktësojë, llogarisë dhe arkëtojë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,502,350 lekë ndaj 12 subjekteve**, sipas pasqyrës Aneks 28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shkurt 2017

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pagesave të detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore nga punonjësit e Bashkisë Devoll, u konstatua se nga **25 punonjës** të administratës së Bashkisë Devoll, nuk është bërë i mundur likuidimi i taksave e tarifave vendore për vlerën **205,271 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll**.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Devoll, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e **vlerës 205,271 lekë ndaj 25 punonjësve** të administratës së Bashkisë Devoll, sipas pasqyrës Aneks 16 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shkurt 2017

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi ngarkesën fiskale të subjekteve të Bashkisë Devoll dhe ish Komunës Qendër Bilisht, në kundërshtim me vendimet e Këshillit Bashkiak dhe vendimet e Këshillit të Komunës, si dhe të neneve 4, 22, 26 dhe 32, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u konstatuan të ardhura të munguara në buxhet, për: **4 raste me vlerë 2,003,875 lekë** në Bashkinë Devoll dhe **3 raste me vlerë 306,939 lekë** në ish Komunën Qendër Bilisht.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **2,310,814 lekë, respektivisht:**

-vlera **153,305 lekë** nga subjektet ■ dhe ■.

-vlera **164,200 lekë** nga subjekti ■.

-vlera **940,115 lekë** nga subjekti ■;

-vlera **746,255 lekë** nga subjekti ■.

-vlera **108,400 lekë** nga subjekti ■.

-vlera **126,500 lekë** nga subjekti ■.

-vlera **72,039 lekë** nga subjekti ■.

Brenda muajit Shkurt 2017

4. Gjetje nga auditimi: Ish Kryetari i Komunës Progër **z. A. A.**, është paguar për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit në vlerën **13,500 lekë/muaj** (dhjetor 2013), veprim në kundërshtim me nenin 1, të ligjit nr. 169/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik në Bashkinë Devoll, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **13,500 lekë**, nga ish Kryetari i Komunës Progër **z. A. A** për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit.

Brenda muajit Shkurt 2017

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Devoll (ish Bashkia Bilisht), janë kryer pagesa për shpërblimin e këshilltarëve të Këshillit Bashkiak për çdo muaj mbi bazën e listë prezencave të pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë nuk përkon me listë prezencat e dorëzuara, duke paguar padrejtësisht shpërblimi në vlerën **1,308,483 lekë, me dëm në buxhetin e Bashkisë Devoll**, në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, i ndryshuar me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pika 1 e nenit 51-Të drejtat e Këshilltarit.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,308,483 lekë nga këshilltarët e Bashkisë Devoll**.

Brenda muajit Shkurt 2017

6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumenteve të bankës për pagesën e këshilltarëve dhe kryepelqve të ish komunave Progër, Miras, Hoçisht dhe Qendër Bilisht, u konstatua se tatimi mbi shpërblimin (në burim) nuk është llogaritur në nivelin 15% por 10%, veprim në kundërshtim me nenin 28 “*shkalla tatimore*”, të ligjit nr. 177/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, **me dëm në buxhetin e shtetit për vlerën 795,241 lekë**.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **795,241 lekë nga këshilltarët dhe kryepelqtë** e ish Komunës Progër për vlerën 208,436 lekë, Qendër Bilisht për vlerën 225,249 lekë, miras për vlerën 197,265 lekë dhe Miras për vlerën 164,291 lekë.

Brenda muajit Shkurt 2017

7. Gjetje nga auditimi: Në strukturën organizative të ish Komunës Qendër Bilisht është përcaktuar pozicioni “Drejtor Finance” me 1 (një) punonjës dhe Drejtor Urbanistike me 1 (një) punonjës, duke e kategorizuar në klasën II-b me pozicion page 34,700 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, pika 23 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02/07/2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

Emërimi në këto dy pozicione, duhet të klasifikohej si përgjegjës zyre me klasën III-b me pozicion 28,870 lekë për vitin 2013 dhe vlerën 29,440 lekë për vitet 2014-2015, duke bërë pagesa të kundërligjshme **me dëm në buxhetin e ish Komunës Qendër Bilisht për vlerën 239,606 lekë**.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **239,606 lekë, respektivisht:**

-vlera **68,651 lekë nga znj. V. B.**, në pozicionin ish Drejtor Finance Komuna Qendër Bilisht.
-vlera **131,614 lekë nga znj. T. S.**, në pozicionin ish Drejtor Zyrës Urbanistikës.

Brenda muajit Shkurt 2017

8. Gjetje nga auditimi: Referuar strukturës organizative të ish Komunës Qendër Bilisht dhe Hoçisht, u konstatua se:

a-Në pozicionin e miratuar “Inspektori i Policisë së Komunës Qendër Bilisht”, është paguar z. E. H. me pagë 40,600 lekë. Referuar urdhrin nr. 3, datë 12.03.2007 (shkresa nr. 77/1, datë 12.03.2007) të ish Kryetarit të Komunës z. R. H. dhe në zbatim të nenit 44, germa “f”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, z. E.H. me arsim të mesëm, emërohet në pozicionin “*police dhe shofer i komunës*”, i cili duhet paguar për vlerën 38,500 lekë/muaj ose paguar gabimisht në pozicionin e Inspektor Policie për vlerën **54,244 lekë (neto)**, me dëm në buxhetin e ish Komunës Qendër Bilisht.

b- Në pozicionin e miratuar “Kryeinspektor i Policisë së Komunës Hoçisht”, është paguar z. H. G. me pagë 52,500 lekë. Nga dokumentacioni në dosjen e personelit, konstatohet se z. H. G. ka përfunduar shkollën e mesëm bujqësore pa shkëputje nga puna, duke mos paraqitur asnjë dokument që tregon se është diplomuar në Akademinë e Policisë ose të ketë kryer kurse trajnimi dhe kualifikimi në fushën e policisë, veprime këto në kundërshtim me nenet 3 dhe 7, të ligjit nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”.

Mungesa e arsimit dhe kualifikimeve nuk përputhet me emërtimin si Kryeinspektor Policie me pagë 52,500 lekë, **me dëm në buxhetin e ish Komunës Qendër Bilisht për vlerën 63,336 lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë” dhe lidhjes 5, të VKM nr. 518, datë 16/08/2012, VKM nr. 586, datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02/07/2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

8.1. Rekomandimi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **117,560 lekë, respektivisht:**

-vlera **54,244 lekë nga z. E. H.** në funksionin ish Inspektor i Policisë së Komunës Qendër Bilisht;

-vlera **63,336 lekë nga z. H. G.** në funksionin ish Kryeinspektor i Policisë së Komunës Hoçisht.

Brenda muajit Shkurt 2017

9. Gjetje nga auditimi: Në strukturë organizative të ish Komunës Hoçisht është përcaktuar pozicioni “Drejtor Finance” me 3 punonjës, duke e kategorizuar në klasën II-b me pozicion page 34,700 lekë për vitin 2013 dhe 35,900 lekë për vitet 2014 dhe 2015, veprim në kundërshtim me VKM nr. 474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, i ndryshuar me Vendim nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishtme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, pika 23 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02/07/2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, duke bërë pagesë të kundërligjshme **me dëm në buxhetin e ish Komunës Hoçisht për vlerën 193,460 lekë (bruto).**

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **193,460 lekë** nga **z. E. R.**, në funksionin ish Drejtor Ekonomik në Komunën Hoçisht.

Brenda muajit Shkurt 2017

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e strukturës organike të miratuara dhe urdhrave të Titullarit të ish Komunës Hoçisht, u konstatua se janë lidhur kontrata të përkohshme dhe janë bërë pagesa në muaj të ndryshëm për punonjës shërbimi (elektracist dhe hidraulik), në vlerën 320,400 lekë.

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur bankës mbi pagesat e punonjësve me kontratë të përkohshme, u konstatua se në **2 raste** pagesat nuk janë në përputhje me pikën 26 e nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit” dhe pikave 34, 35, 36 dhe 38, të UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pasi nuk ka dokumentacion argumentues për të provuar orët e punës së punonjësve (kohëshënuesin), preventivin e punimeve të kryera, akt-marrje në dorëzim të punimeve të kryera, etj. Gjithashtu, konstatohet se akt-marrëveshja është lidhur në një periudhë të mëvonshme se sa kryerje e likuidimit dhe që nuk përputhet me afatin në akt-marrëveshje, duke kryer pagesa të kundërligjshme për vlerën **199,800 lekë, me dëm në buxhetin e ish Komunës Hoçisht.**

Për këto punonjës është mbajtur tatimi në burim në masën 10% për vlerën **32,040 lekë**, i cili nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **199,800 lekë, respektivisht:**

-vlera **70,200 lekë**, nga ish punonjësit me kontratë **z. P. M.;**

-vlera **129,600 lekë** nga ish punonjësit me kontratë **z. L. B.;**

si dhe të arkëtojë në buxhetin e shtetit detyrimin për tatimin mbi të ardhurat **vlerën 32,040 lekë**, të mbajtur por të pa likuiduar në vitin 2014.

Brenda muajit Shkurt 2017

11. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Miras është lidhur kontratë qiraje nr. s’ka, datë 31.05.2011 me shoqërinë [REDAKTUAR] me përfaqësues z. P.M. për sipërfaqen inproduktive pyjore/kullosore prej 4810 m² (ose 3.207 km), me objekt “shtrirjen e linjës së veprës marrje ujë, trase dhe 140 m² zall, me afat përdorimi 10 vite, në ZK. 829 pf; 854 pf; 1387 rrugë; 850 pf; 368 pf; 321 tokë pyll; 1381 rrugë dhe 1384 zall lumi, me tarifë 13 lekë/m²/vit dhe detyrimi vjetor në vlerën 62,530 lekë/viti. Tarifa e kontratës nuk është lidhur sipas pasqyrës 11, pika 6, të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pasi vlera e qirasë është 145,000 lekë/km/vit me detyrim vjetor 465,015 lekë ose më pak për vlerën 82,470 lekë/vit dhe për periudhën 5 vjeçare në vlerën **2,325,075 lekë, si një e ardhur e munguar në buxhetin e ish Komunës Miras.**

Sipas të dhënave të zyrës së financës, subjekti deri në vitin 2014 nuk ka likuiduar vlerën prej **143,550 lekë**, për të cilën nuk është bërë i mundur përlllogaritja e kamat vonesave në masën 0.01% deri në 10 %, sipas pikës 6 e nenit 5, të kontratës së qirasë, në vlerën **14,355 lekë.**

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **2,482,980 lekë nga subjekti [REDAKTUAR], respektivisht:**

-vlera **2,325,075 lekë**, detyrim jo në zbatim të VKM;

-vlera **143,550 lekë**, detyrim i paarkëtuar;

-vlera **14,355 lekë**, kamatëvonesë për mos likuidim detyrimi në afat.

Brenda muajit Shkurt 2017

12. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të zyrës së financës të ish Komunës Progër, u konstatua se subjekti ■ me përfaqësues ligjor z. A. Xh. nuk ka paguar detyrimin e qirasë për sipërfaqen pyjore në përdorim sipas kontratave nr. 7571/4550, datë 27.11.2013, nr. 7571/4551, datë 27.11.2013 dhe nr. 4257/3506, datë 24.12.2009, në vlerën **1,050,000 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e ish Komunës Progër**, si dhe nuk është bërë i mundur përlllogaritja e kamat vonesave në masën 10%, sipas pikës 5.6 të kontratës për vlerën **105,000 lekë**.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,155,000 lekë nga subjekti ■**, nga e cila vlera prej 1,050,000 lekë (detyrim i pa arkëtuar) dhe vlera prej 105,000 lekë (kamatëvonesë për mos likuidim detyrimi).

Brenda muajit Shkurt 2017

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin mbi administrimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave të ish Komunës Progër, u konstatua se kryen aktivitet shfrytëzim karriere subjekti privat ■, duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore në pronësi/përdorim të ish Komunës Progër. Subjekti është pajisur me leje shfrytëzimi nr. 1071, datë 10.09.2007 “Për shfrytëzimin e sipërfaqes për hapje karriere prej 0.064 km² ose 6.4 ha dhe afat 10 vjeçar, me adresë fshati Progër, rrethi Devoll”, **por që nuk ka lidhur kontratë qiraje për këtë sipërfaqe** me qëllim përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhet për vlerën **16,896,000 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006, neni 38, germa “q” dhe nenin 40/1-Vlerësimi i dëmit, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja 2, si dhe ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

Sipas të dhënave të zyrës së financës, rezulton se subjekti paraqitet debitor për vlerën **342,800 lekë**.

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Devoll, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqes pyjore/kullosore të shfrytëzuar nga subjekti ■ shpk, duke lidhur kontratë ligjore (para noterit publik), në përputhje me nenin 39 germa (f), nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, i ndryshuar, si dhe përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **17,238,800 lekë**, nga e cila vlera prej 16,896,000 lekë (detyrim i llogaritur sipas VKM nr. 1064) dhe vlera prej 342,800 lekë (detyrim i padredhur) nga subjekti privat ■.

Brenda muajit Shkurt 2017

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së dhënies së lejes së ndërtimit në ish Komunën Progër ndaj subjektit ■ shpk dhe R.Th. u konstatua se taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur sipas vlerës së investimit (çmimeve për njëjësi) për objektin “*Rikonstruksion reparti grumbullimi kërmilli dhe bime medicinale, me investor “■” & “■”*”, të përcaktuar në UKM nr. 2, datë 06.08.2014 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2014”, duke paguar më pak vlerën **968,710 lekë** (sipërfaqe 2000 m² x 32,544 lekë/m² x 2 % (taksa sipas paketës fiskale) = 1,301,760 lekë – 333,050 lekë detyrim i paguar), **si një e ardhur e munguar në buxhetin e ish Komunës Progër**.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillim Planifikim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **968,710 lekë** për objektin “Rikonstruksion reparti grumbullimi kërmilli dhe bime medicinale, nga subjektet ■■■ Shpk dhe R.Th.

Brenda muajit Shkurt 2017

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të likuidimeve me bankë në vitin 2013 të ish Komunës Qendër Bilisht, u konstatua e në 2 raste janë kryer shpenzime për blerje materiale (tuba për ujësjellësin) në shumën 677,540 lekë, vlerë e cila nuk është bërë hyrje dhe dalje nga magazina, duke mos lënë asnjë gjurmë për lëvizjen e këtyre mallrave (aktiveve), veprim në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”, pikat 35-43,52,54 dhe 60, **me dëm ekonomik në buxhetin e ish Komunën Qendër Bilisht në vlerën 677,540 lekë.**

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **677,540 lekë**, nga nëpunësi zbatues **znj. V. B.** në funksionin ish Drejtor Finance (aktualisht specialiste në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Devoll), për kryer e pagesën dhe bërë kontabilizimin në mungesë të dokumenteve vërtetues fletë-hyrjes dhe fletë-daljes për blerjen e këtyre mallrave.

Brenda muajit Shkurt 2017

16. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtimi i sistemit të ngrohjes së Bashkisë Devoll, viti 2013” fituar nga OE ■■■, u konstatua se në koston e punimeve të ndërtimit (preventivit) është përfshirë tvsh e makinerive dhe pajisjeve (radiator, kaldajë çeliku me dru dhe pompë qarkullimi monofazë), veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston se punimeve te ndërtimit”, **me dëm në buxhet për vlerën 167,400 lekë.**

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **167,400 lekë**, nga subjekti ■■■.

Brenda muajit Shkurt 2017

17. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kushteve të kontratës nr. 946, datë 10.12.2015 midis Bashkisë Devoll dhe kontraktorit ■■■, me objekt “Punime mirëmbajtje të shkollave të Bashkisë Devoll, viti 2015” me vlerën 3,899,811 lekë, u konstatua se punimet kanë përfunduar me **68 ditë vonesë.** Referuar nenit 34 “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës, për mos përfundim të punimeve në afat ndaj kontraktorit duhej llogaritur kamatëvonesë në vlerën **265,187 lekë.**

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **265,187 lekë**, nga subjekti ■■■.

Brenda muajit Shkurt 2017

18. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e arsytimit të s`kualifikimit të OE ■■■, nga komisioni i vlerësimit të ofertave të ish Komunës Progër (në sistemin e app.gov.al), u konstatua se arsyeja e s`kualifikimit nuk qëndron pasi OE ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore të vlefshme deri më datë 09.10.2013, ndërkohë që procedura e prokurimit është hapur me datë 26.09.2013, duke shkaktuar një **dëm ekonomik në vlerën 37,210 lekë.**

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **37,210 lekë**, *respektivisht:*

- vlera **12,403 lekë nga z. N.Sh.** në funksionin e Kryetarit të KVO.
- vlera **12,403 lekë nga znj. A.T.** në funksionin e anëtarit të KVO.
- vlera **12,403 lekë nga z. N.H.** në funksionin e anëtarit të KVO.

Brenda muajit Shkurt 2017

19. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin me objekt “*Rehabilitimi i rrugës Cangoj, viti 2013*”, të zhvilluar më datën 17.05.2013 për të cilin është lidhur kontrata datë 18.06.2013 me vlerë 30,762,165 lekë (me tvsh) me BOE █████ shpk & █████ shpk, rezulton se arsyetimi për s`kualifikimin e OE █████ shpk, nga KVO të ish Komunës Progër (në sistemin e app.gov.al) nuk qëndron, pasi mangësitë e konstatuara kanë të bëjnë me faktin se këto dokumente nuk u janë hapur në këtë sistem (fakt i vërtetuar nga auditimi) dhe në procesverbal janë trajtuar sikur këto dokumente nuk janë paraqitur. Bazuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu XI “Manualet dhe trajnimi”, KVO duhej t`i drejtohej APP për ndihmë në hapjen e dokumenteve, për të cilat KVO ka s`kualifikuar këta OE. Me mosveprimet e tij, KVO në vlerësimin e ofertave ka kualifikuar me të padrejtë OE █████ shpk, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 5,769,258 lekë** (oferta fituese 25,635,137 lekë - 19,865,879 lekë oferta e █████ shpk).

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,769,258 lekë, respektivisht:**

- vlera **1,923,086 lekë nga z. N.Sh.** në funksionin e Kryetarit të KVO.
- vlera **1,923,086 lekë nga znj. A.T.** në funksionin e anëtarit të KVO.
- vlera **1,923,086 lekë nga z. N.H.** në funksionin e anëtarit të KVO.

Brenda muajit Shkurt 2017

20. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të mbajtur mbi përdorimin e karburantit nga Bashkia Devoll dhe ish komunave Qendër Bilisht dhe Progër, u konstatua se si rezultat i pasaktësisë së përcaktimit të normativës së harxhimit të karburantit për 100 km dhe orë pune, disa makina kanë punuar me 2 standarte.

Në fletë udhëtimet e automjeteve të pastrimit, i njëjti shërbim i kryer në ditë të ndryshme paraqitej në sasi km të ndryshme për të njëjtin itinerar dhe në sasi orësh të ndryshme. Për një pjesë të sasisë së karburantit të furnizuar mungon dokumentacioni justifikues ose kur ai ekziston është i mangët ose nuk ka vlerë ligjore të një dokumenti financiar, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35/b Pika 36, **me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Devoll dhe ish komunave Qendër Bilisht, Hoçisht dhe Progër në vlerën 1,947,816 lekë.**

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,654,590 lekë, respektivisht:**

- vlera **588,118 lekë nga z. E.K.** me detyrë specialist veteriner në Agjencinë e Shërbimeve Mjedisore, Bujqësore dhe Veterinare.
- vlera **59,972 lekë nga z. K.S.** me detyrë specialist trajner në Sektorin e Sportit.
- vlera **135,341 lekë nga z. U.M.** në funksionin ish shofer.
- vlera **72,135 lekë nga z. J.P.** në funksionin ish Administrator i Njesisë Administrative Hoçisht.
- vlera **29,971 lekë nga z. A.M.** me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Miras;
- vlera **191,914 lekë nga z. G.G.** në funksionin ish Nënkryetar i Komunës qendër Bilisht dhe Përgjegjës i Zyrës Shërbimeve;
- vlera **385,222 lekë nga znj. V.B.** me detyrë specialiste e taksave, në cilësinë e osh-Drejtoreshës Ekonomike Komuna Qendër Bilisht;
- vlera **191,914 lekë nga z. E.H.** në funksionin ish Kryeinspektor Policie, Komuna Qendër Bilisht.

-vlëra **59,143 lekë nga z. N.H.** në funksionin ish Drejtor Shërbimesh Komuna Progër;
-vlëra **78,028 lekë nga z. E.R.** në funksionin ish Drejtor Ekonomik Komuna Hoçisht;
-vlëra **78,028 lekë nga z. O.C.** me detyrë arkëtar në Njësinë Administrative Hoçisht;
-vlëra **78,028 lekë nga z. D.Sh.** me detyrë specialist i MMT në Sek/Zhvillimit dhe mbrojtjes së tokës

Brenda muajit Shkurt 2017

21. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të likuidimit të vlerës kontratës datë 24.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i tualeteve të shkollës “Myrteza Sala” me bashkimin e operatorëve ekonomik ■ shpk & ■ shpk në Bashkinë Devoll, u konstatuan se mallrat janë lëvruar me **78 ditë vonesa**, për të cilat nuk janë mbajtur sanksione për kamatëvonesat **me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Devoll për vlerën 50,413 lekë.**

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **50,413 lekë nga BOE ■ Shpk dhe ■ Shpk.**

Brenda muajit Shkurt 2017

22. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të likuidimit të vlerës kontratës datë 22.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i tualeteve të shkollës “Dritëro Agolli” me bashkimin e operatorëve ekonomik ■ shpk & ■ shpk në Bashkinë Devoll, u konstatuan se mallrat janë lëvruar me **80 ditë vonesa**, për të cilat nuk janë mbajtur sanksione për kamatëvonesat **me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Devoll për vlerën 59,401 lekë.**

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **59,401 lekë nga BOE ■ Shpk dhe ■ Shpk.**

Brenda muajit Shkurt 2017

23. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacioni të shpenzimeve me bankë në ish Komunën Progër, u konstatua se në **3 raste** janë kryer shpenzime për mirëmbajtje rrugësh, kanalesh kullues, çakullim etj, mbi bazën e një dokumentacioni të pa rregullt ligjor, në kundërshtim me neni 2, pika 19 dhe 26 e nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe urdhrin nr. 33, datë 11.07.2013 “Për Gjurmët Standarte të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, në shkelje të disiplinës financiare **me dëm ekonomik në buxhetin e ish Komunën Progër për vlerën 936,300 lekë.**

23.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **936,300 lekë, respektivisht:**

-vlëra **312,100 lekë nga z. A.A.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Progër;

-vlëra **312,100 lekë nga z. N.Sh.** me detyrë ish Nënkryetarit të Komunës Progër;

-vlëra **312,100 lekë nga z. N.H.** me detyrë ish Drejtor Shërbimesh Komuna Progër.

Brenda muajit Shkurt 2017

24. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacioni të shpenzimeve me bankë në ish Komunën Progër, u konstatua se në **3 raste** janë kryer shpenzime për telefoni celulare në adresë të ish Kryetarit të Komunës z. A.A. **me dëm ekonomik në buxhetin e ish Komunën Progër për vlerën 127,894 lekë**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave, publikë”.

24.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **127,894 lekë**, nga ish Kryetari i Komunës Progër **z. A.A.**

Brenda muajit Shkurt 2017

25. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumenteve të bankës, u konstatua se ish Komuna Qendër Bilisht ka bërë pagesa në vlerën 630,000 lekë me objekt shpenzimi “Kontributi për Fondacionin “██████” (OJF), në bazë të marrëveshjes së bashkëfinancimit të lidhur ndërmjet ish Komunës dhe Fondacionit datë 12.02.2015, për realizimin projektit “Kujdesi për familjen”, nëpërmjet ofrimit të përbashkët të ndihmës ushqimore dhe materiale për 30 familje të varfra nga ish Komuna Qendër Bilisht. Dokumentacioni vërtetues i paraqitur nga Fondacioni në funksion të zbatimit të aktmarrëveshjes dhe kontributit të përfituar nga komuna nuk plotëson kërkesat e dokumentit ligjor financiar, pasi kartelat e shpërndarjes personave përfitues, herë janë firmosur herë jo, mungesë të numrit të identifikimit, si dhe plotësuar dhe firmosur nga i njëjti shkrim.

Në asnjë rast nuk janë paraqitur faturat financiare të blerjes së mallrave. Kryerja e shpenzimit mbi bazën e një dokumentacioni jo të rregullt financiar justifikues për vërtetimin e realizimit të këtij projekti është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26 dhe 12 me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35, 36, 38, 52, 54 dhe 60.

25.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **630,000 lekë nga Fondacionin “██████” (OJF)**, përfituar mbi bazën një dokumentacioni financiar të pa plotë e të parregullt dhe jo ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2017

26. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e shpenzimeve operative për udhëtime dieta në ish Komunën Miras, u konstatua se në 2 raste me vlerë **37,500 lekë** janë kryer pagesa në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëseve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, pasi nuk përcaktohet qëllimi ose arsyeja e lëvizjes, nuk disponohen biletat përkatëse të udhëtimit.

26.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **37,500 lekë, respektivisht:**

- vlera **15,000 lekë nga znj. M.H.** në funksionin ish Sekretare e Kryetarit;
- vlera **15,000 lekë nga z. K.S.** në funksionin ish Kryetar i Komunës Miras;
- vlera **5,000 lekë nga z. I.Z.** në funksionin ish Specialist i Ndihmës Ekonomike;
- vlera **2,500 lekë nga znj. E.H.** në funksionin ish Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile.

Brenda muajit Shkurt 2017

27. Gjetje nga auditimi: Ish Bashkia Bilisht (sot Bashkia Devoll), për periudhën 2009-2015 ka lidhur 1 kontratë fillestare me afat 2 vjeçar dhe 5 kontrata me afat një vjeçar me subjektin privat ██████ Shpk, ku Bashkia **nuk është bashkë themeluese në këtë subjekt**, në kushtet e pamjaftueshmërisë së kompetencave të autoritetit dhe të pabazueshmërisë ligjore, pasi 5 kontratat me afat 1-vjeçare **janë lidhur pa marrë miratim në Këshillin Bashkiak**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 32 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak”, pika (d, e, gj, k) dhe neni 44 pika (a).

Objekti i këtyre kontratave është: “Bashkëpunimi midis këtyre palëve për zhvillimin e aktivitetit sportiv në Qytetin Bilisht në përputhje me standartet dhe kushtet teknike të miratuara nga Federata e futbollit...”

Në rastin e kontratës së parë apo fillestare të datës 28.07.2009 pjesë e këtij neni në vazhdim është edhe fraza shtesë: “*e ndarë në % Bashkisë Bilisht e përfaqësuar nga Kryetari i saj z. V.M, ██████ Shpk me seli në Bilisht me përfaqësues ligjor z. S.M*”.

Neni 2 “Baza ligjore”, i cili përcakton që: “*Ligji i aplikueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar dhe në bazë të marrëveshjes midis dy palëve, si dhe të Kodit Civil të Republikës së*

Shqipërisë, ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 10, pika 3/II germa “b”, ligjit nr. 9376 datë 21.04.2005 “Për Sportin” midis: Bashkisë Bilisht e përfaqësuar nga kryetari i saj, z. V. M. (me 49%) dhe █████ shpk, me seli në Bilisht me përfaqësues ligjor z. S.M. (me 51%)”.

Në rastin e kontratës së parë apo fillestare të datës 28.07.2009 pjesë e këtij neni janë përcaktuar dhe përqindjet pjesëmarrjes së palëve: 49% Bashkia Bilisht dhe 51% Klubi i Futbollit █████ shpk.

Klubi i Futbollit █████ shpk sipas QKR është Shoqëri e krijuar me datë 06.02.2009, me kapitali 100,000 lekë dhe pjesëmarrje në kapital në masën 100% (ortak i vetëm), me objekt veprimtarie “Ushtrimi i aktivitetit sportiv për krijimin e një skuadre sportive futbollit”.

Neni 5 “Afati” i cili përcakton që: “Kjo kontratë lidhet me datën ..deri me datën...(përkatëse) në përfundimin sezonit futbollisti për të dyja fazat e këtij kampionati të aktivitetit sportiv në qytetin e Bilishtit me të drejtë ripërtëritje në bazë të marrëveshjes midis palëve”

Neni 8 “Detyrimet e palëve” i cili përcakton: “Përsa më sipër Palët kanë të drejtat dhe detyrimet sipas të gjitha dispozitave dhe kushteve që janë përcaktuar në bazë të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin” dhe si më poshtë:

1. Bashkia Bilisht vë në dispozicion fushën e futbollit që është në pronësi të saj dhe të gjitha ambientet sportive (dhomë zhveshje, dhomat e gjumit, energjinë elektrike, ujin, ngrohja gjatë periudhës së dimrit).

2. Bashkia Bilisht merr përsipër për udhëtimet jashtë rrethit ushqimin, fjetjen dhe transportin.

3. Bashkia Bilisht merr përsipër transportin e lojtarëve për stërvitjen e tyre brenda rrethit, bazën materiale të lojtarëve (topa, këpucë, uniforma përfaqësie)

4. Bashkia Bilisht merr përsipër plotësimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve vetëm për periudhën e kampionatit futbollistik.

5. Në periudhën e kampionatit Bashkia Bilisht do të njohë vetëm udhëtimin e lojtarëve që janë nga qyteti i Korçës me linjën Bilisht-Korçë-Bilisht.

6. Bashkia Bilisht përveç ndeshjeve zyrtare dhe miqësore, vë në dispozicion të ekipit fushën sipas një programi të detajuar që varet nga programi i trajnerit për seancë stërvitore....

Detyrimet e palës tjetër

Klubi i futbollit █████ shpk Bilisht me përfaqësues ligjor z. S. M. merr përsipër plotësimin e të gjitha nevojave të tjera për zhvillimin e këtij aktiviteti futbollistik, ku shprehet se:

1.- Klubi i Futbollit █████ shpk Bilisht është i detyruar të respektojë kalendarin e federatës së futbollit për kategorinë e parë(I).

2.-Të gjitha ndeshjet e ekipit të Klubit të Futbollit █████ shpk të zhvillohen në stadiumin e qytetit Bilisht.

3.-Ndeshjet e ekipit të rinjve e para të rinjve të Klubit të Futbollit █████ shpk janë të detyruar të zhvillohen në stadiumin e qytetit Bilisht.

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë, zgjidhen duke u drejtuar në Gjykatën e rrethit kompetent.

Neni 10 “Të përbashkëta”, ku përcakton se: “Kjo kontratë hartohet në 4-kopje dhe quhet e vlefshme pasi të jetë aprovuar nga të dy palët e cila lexohet me zë të lartë dhe firmoset nga palët (nga një kopje për të dy palët, një kopje Shefi i klubit, një kopje në financë).”

Konstatohet se kontrata e datës 15.06.2015 është miratuar me VKB nr. 19, datë 20.08.2015, gjë e cila tregon se Kryetari i Bashkisë ka lidhur kontratën përpara se të bëjë propozimin në Këshillin Bashkiak me projekt-vendim, për miratim ose jo të bashkëpunimit me █████, **para marrjes së vendimit të Këshillit Bashkiak.**

Këshilli Bashkiak ka miratuar me vendim kontratën e lidhur nga ish Kryetari i Bashkisë Bilisht z. V. M., mbi një veprim të kryer jashtë kompetencave nga titullari i njësisë vendore,

veprim të cilin e ka kompetencë vetë Këshilli Bashkiak ta miratoje, ç'ka e bën të pavlefshëm ligjërish VKB nr. 19 datë 20.08.2015, pasi është Këshilli Bashkiak ai që vendos nëse duhet lidhur kontrata apo jo dhe nëse është e ligjshme.

Mbledhja e Këshillit Bashkiak është zhvilluar sipas kërkesës së bërë nga presidenti i klubit (subjekt privat), veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, neni 30, pikat 2 e 3.

Këto kontrata janë hartuar në papajtueshmëri me Titulli I, Kreu I nenet 659, 662, 663, 667, 678, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", pasi objekti i kontratës nuk është përcaktuar saktë, pasi mungojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, detyrimet financiare janë parashikuar të njëanshme (vetëm për ish Bashkinë Bilisht), **kundrejt ofrimit të asgjëje nga pala tjetër** (klubi i futbollit █████ shpk), mungesës së penalitetet, etj., duke i bërë këto kontrata të pavlefshme dhe në kundërshtim me pikën "c" e nenit 116, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Për Kodin e Procedurës Administrative", i ndryshuar.

Përcaktimi në kontratën fillestare i përqindjes së pjesëmarrjes me aksione, kur nga palët nuk ka akt-themelimi për krijimin e Shoqërisë Tregtare apo Anonime dhe nuk ka kapital të përbashkët në bazë të kontributeve përkatëse të secilit është veprim në kundërshtim me neni 18/2, neni 19 dhe neni 20, të ligjit nr. 9376 datë 21.05.2005 "Për Sportin", i ndryshuar, nenin 3 "Shoqëritë tregtare" dhe 10 "Përgjegjësitë e themeluesve" dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Zbatimi i këtyre akteve administrative në kundërshtim me ligjin dhe miratimi nga Bashkia në shpenzimet vjetore në Buxhet për subjektin privat "Klub futboll █████ Shpk, për përbalimin e shpenzimeve për udhëtim e dietave, të veshjeve dhe materialeve sportive, të medikamenteve dhe shërbimit mjekësore, janë veprime financiare **me efekt negativ me dëm në buxhet për vlerën 17,263,893 lekë**, nga e cila .

Referuar pikës 1 e nenit 8, të kontratës datë 28.07.2006 Bashkia i ka vënë në **përdorim pa shpërblim (qira)** subjektit privat "Klub futboll █████ ambientet sportive (*fushën e sportit dhe ambientet ndihmëse*) me sipërfaqe 8010 m², ku me VKM nr. 764, datë 07.11.2012 "Për listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në përdorim, pronësi të Bashkisë Bilisht", objekt është pronë e Bashkisë Bilisht, duke mos llogaritur dhe arkëtuar qiranë për ambienteve sportive (aseteve) për vlerën **23,469,300 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin", i ndryshuar, pika 3 e nenit 19 "Klubet sportive", VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore" pika 6/c e kreut I, pika 6 e kreut III, me VKM nr. 529 datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", pika 5 e kreut III, i ndryshuar me VKM nr. 54 datë 05.02.2014, Kreu III, si dhe ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 106.

27.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **17,263,893 lekë**, nga subjekti privat "**Klubi Futbollit █████ shpk**, i cili ka përfituar me pa të drejtë këtë shumë sipas kontratave të paligjshme.

Brenda muajit Shkurt 2017

28. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të likuidimeve me bankë, u konstatua e janë kryer shpenzime "*Shërbimi për pastrimin nga dëborë*" me operatorin ekonomik █████ shpk, në kundërshtim me Kreun II, pika 2, Kreun VI pika 2/a, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 "Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë" tabela 1/3. Në ofertat e paraqitura nuk është përcaktuar lloji i makinerisë që kryen këtë shërbim dhe çmimi nuk i është referuar çmimit zyrtar të miratuar për raste emergjence. Çmimi për orë pune është përcaktuar 6,000 lekë/orë

pune, kur për fadromë tip volvo, e cila zakonisht përdoret për largim mbeturinash apo pastrim bore çmimi i miratuar është 3,607 lekë/ orë/pune. Pra midis çmimit të miratuar dhe çmimit të paguar ka një diferencë prej 2,393 lekë/orë/pune, pagesë në kundërshtim me VKM nr. 654, datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e përkohshëm nga organe shtetërore në situata emergjente të çdo mjeti privat”, **me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Devoll për vlerën 111,274 lekë.**

28.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **111,274 lekë, respektivisht:**

-vlera prej **37,091 lekë** nga **znj. A.F.** në funksionin e Kryetarit të KPVV;

-vlera **37,091 lekë** nga **znj. E.Sh.** në funksionin e anëtarit të KPVV;

